



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 136, datë 06.10.2011

MBI

KONTRIBUTET SHITESË TË FONDIT TË KOMPENSIMIT PËR VITIN 2011

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nenit 45, paragrafi 4, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në bazë të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 45 “shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e R.Sh në sigurimin e detyrueshëm motorik, janë të detyruara të kontribuojnë çdo vit financiarisht në fondin e kompensimit, në përpjestim të drejtë me primet bruto të shkruara në këto lloj sigurimesh, në vitin paraardhës. Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve, sipas pikave 2 e 3 shkronja b, dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja. Gjithashtu burime të tjera të fondit të kompensimit sipas pikës 3 të nenit 45 është dhe kontributi shtesë i shoqërive të sigurimit, kur fondi i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat e dëmeve.

Byroja Shqiptare e Sigurimit ka depozituar në Autoritet, informacionin me shkresën nr. 4715, datë 12.09.2011 mbi përdorimin e fondit të kompensimit për periudhën janar-gusht 2011, si dhe nevojat për shtesë të fondit të kompensimit në masën 333,724, 920 lekë. Për sa më sipër, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e propozimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit për kontribute shtesë të fondit të kompensimit, në masën 333,724,920 lekë, sipas përlllogaritjeve të Byrosë bashkëlidhur.
2. Ky fond duhet të derdhet në përputhje me parashikimet e nenit 3, paragrafi 10, i Rregullores nr. 22, datë 19.03.2010 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”.
3. Ngarkohet Byroja dhe departamentet përkatës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

